



Tiranë më 15 Janar, 2025

Njoftim për ndryshim të thirrjes për grup ekspertësh

REC Shqipëri njofton për ndryshimet e mëposhtme në thirrjen për grup ekspertësh **“Për hartimin e Raportit Diagnostik mbi rolin e prokurorisë në hetimin dhe ndjekjen e dëmeve në mjedis në Shqipëri”**.

1. Zgjatje e Afatit të Dorëzimit

Për të ofruar më shumë kohë për palët e interesuara që të përgatitin dhe dorëzojnë aplikimet e tyre, afati i dorëzimit të aplikimeve është zgjatur. Afati i ri për dorëzimin e aplikimeve është data **31 Janar 2025**.

2. Publikimi i Vlerës Maksimale

Për të rritur transparencën dhe për të tërhequr një gamë më të gjerë aplikantësh, është vendosur të publikohet vlera maksimale e thirrjes. Buxheti maksimal i disponueshëm për këtë thirrje është **6,250.00 Euro** (bruto).

Aplikimet që tejkalojnë këtë shumë nuk do të merren në konsideratë.

Të gjitha kushtet dhe rregullat e tjera të thirrjes për aplikim mbeten të pandryshuara.

Dokumentacioni i përditësuar i thirrjes, duke përfshirë këtë ndryshim, është i disponueshëm në: <https://ww2.recshqiperi.org/2024/11/07/thirrje-per-grup-ekspertesh-per-hartimin-e-raportit-diagnostik-mbi-rolin-e-prokurorise-ne-hetimin-dhe-ndjekjen-e-demeve-ne-mjedis-ne-shqiperi/>

Për pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni nëpërmjet adreses së email-it projects@recshqiperi.org.

